

## **Marreveshje Transferimi te Pjeseve te Kapitalit**

Ne Durres, me date 01.07.2019 nenshkruhet kjo marreveshje kalimi kuotash mes paleve te meposhteme:

### **Shitesi :**

Zj. **Elton Saliaj** lindur më 10.03.1997 në Rostovec, banuese në Tirane, mbajtëse e kartes se identitetit me numër J70310021F, madhor me zotësi të plotë për të vepruar në cilësinë e Ortakut zotërues të 60% të kapitalit të Shoqërisë të Shoqërisë “NEO ELECTRONICS” sh.p.k shoqeri shqiptare me pergjegjesi te kufizuar me nipt L82127001I themeluar sipas legjislacionit te Republikes se Shqiperise, e regjistruar regjistruar regullisht ne Qendren Kombetare Shqiptare te Regjistrimit me seli në Lagjja Njesia Bashkiake nr 8, Rruga e Bogdaneve, Pallati Eurocol, Kati 0, Nr Pasurie 1/663-N12, Zona Kadastrale 8380, Tirane, Shqipëri.

*dhe*

### **Bleresi:**

**Evis Isufaj** lindur më 22.10.1992 në Fier, banuese në Tirane, mbajtëse e kartes se identitetit me numër J21022063F, madhor me zotësi të plotë për të vepruar në cilësinë e Ortakut zotërues të 40% të kapitalit të Shoqërisë të Shoqërisë “NEO ELECTRONICS” sh.p.k shoqeri shqiptare me pergjegjesi te kufizuar me nipt L82127001I themeluar sipas legjislacionit te Republikes se Shqiperise, e regjistruar regjistruar regullisht ne Qendren Kombetare Shqiptare te Regjistrimit me seli në Lagjja Njesia Bashkiake nr 8, Rruga e Bogdaneve, Pallati Eurocol, Kati 0, Nr Pasurie 1/663-N12, Zona Kadastrale 8380, Tirane, Shqipëri.

### **MEQENESE:**

**Shitesi** zoteron nje kuot qe perfaqeson 60% te Kapitalit te Shoqerise “NEO ELECTRONICS” Sh.p.k. Nje shoqeri ekzistuese sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me date 27.09.2018, me seli ne Lagjja Njesia Bashkiake nr 8, Rruga e Bogdaneve, Pallati Eurocol, Kati 0, Nr Pasurie 1/663-N12, Zona Kadastrale 8380, Tirane, Shqipëri (“Shoqeria”) me nje kapital prej 120,000 (njqind e njezete mije) leke;

- A. **Shitesi** deshiron te transferoje tek Bleresi 9% te kapitalit te zoteruara prej tij ne shoqerine “NEO ELECTRONICS” sh.p.k

- B. Bleresi deshiron te bleje 9 % te kapitalit te kesaj shoqerie (nje kuote) qe aktualisht eshte ne pronesi te Shitesit;
- C. Ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe Nenet e Statutit te Shoqerise, asamblea e ortakeve te shoqerise ka vendosur lidhur me kete transferim, sipas vendimit bashkangjitur kesaj marreveshjeje;

Per sa me siper palet bien dakort si me poshte:

- 1 **Shitesi** deklarom se ka marre nga Bleresi ne menyre te plote te gjithe çmimin e blerjes te rene dakord prej 10.800 LEK dhe per kete arsye transferon ketu 9% te Kapitalit te zoteruar prej tij ne Kapitalin e Shoqerise "NEO ELECTRONICS" sh.p.k., ne pronesi te Bleresit. Shitesi deklarom dhe garantom Bleresin se pjesa e kapitalit e transferuar ketu, eshte ne pronesine e tij te plote ligjore dhe eshte i lire nga barra, hipoteke apo pengje.

Nga ky moment **Evis Isufaj** do te jete pronari i 9% te kuotave ne shoqerine "NEO ELECTRONICS" sh.p.k te cilat aktualisht zoterohen nga **Elton Saliaj** dhe kjo e fundit do te negele me 51% te kuotave te shoqeris.

2. Bleresi pranon pronesine e 9% te kapitalit te shoqerise, duke njohur gjendjen e Shoqerise dhe bie dakort me te gjitha te drejtat dhe detyrimet e lindura nga zoterimi i ketyre Kuotave brenda Shoqerise, sipas percaktimeve te Statutit te Shoqerise dhe ligjit shqiptar.
3. Shitesi dhe Bleresi bien dakort te zbatojne dhe te paraqesin qe ne kerkesen e pare te pales tjetere dhe/ose te Shoqerise te gjitha dokumentet e nevojshme ne menyre qe te kryejne te gjitha veprimet e nevojshme per regjistrimin e transferimit te ketyre Kuotave objekt te kesaj Marreveshjeje, prane Qendres Kombetare e Regjistrimit si dhe ne çdo autoritet tjetere sipas percaktimeve te Ligjit Shqiptar.

Kjo Marreveshje u nenshkrua me vullnet te lire nga ne palet ne 2 (dy) kopje origjinale ne gjuhen shqipe. Marreveshja bazohet n2 nenin 705 te Kodit Civil (Shqiptar) dhe ne Ligjin shqiptar "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", Nr. 9901, date 14.04.2008 dhe Statutit te Shoqerise.

Elton Saliaj

Evis Isufaj